



Udhëzues për Monitorim dhe rishikim të ofruesit pas akreditimit


AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE

Hyrie

Ky udhëzues për monitorimin e ofruesve të cilët janë akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është dizajnuar dhe zhvilluar duke u bazuar në procedurat ekzistuese për të identifikuar zhvillimet në të ardhmen që mund të rrjedhin si rezultat i rritjes së numrit të Ofruesve të Akredituar dhe i rritjes së resurseve të AKK për plotësimin e këtyre kërkesave. Këta mekanizma shtesë do të ndihmojnë AKK-në të monitorojë në mënyrë efektive performancën e ofruesve përmes Aktiviteteve të Mostrimit nga Distanca (AMD) dhe përmes vizitave në lokacionet e ofruesit me qëllim të vëzhgimit të aktiviteteve të kualifikimeve/ moduleve të validuara dhe për të mbledhur fakte që përkrahin përmbajtjen e Raportit të Vetëvlerësimit (RVV) dhe të Planeve të Ofruesit për Përmirësim (POP). Këto udhëzime po ashtu do të mund të integrohen në zhvillimin dhe funksionalizimin e një Procesi për Rishikimin e Ofruesit, që do të mundësojë ofrimin e një pasqyre të performancës së ofruesit të akredituar.

Korniza e zhvilluar për Monitorimin e Ofruesve Pas Akreditimit merr parasysh nevojën që AKK të jetë në gjendje të dëshmojë dhe të bindë veten se Përmirësimi i Vazhdueshëm, përmes Sigurimit të Cilësisë, Ofrimit të Kualifikimeve/ Moduleve të Validuara dhe Vlerësimit të Rezultateve Mësimore, përmbushë kriteret që janë përshkruar në Aplikacionin për Validim të Kualifikimit dhe respekton Udhëzimet Administrative.

AKK pasqyra e monitorimit pas akreditimit



Në këtë aspekt Formularët për Raportim të Monitorimit që ndihmojnë mbledhjen e fakteve për Monitorim Pas Akreditimit, po ashtu do të krijojnë mundësi për referenca të kryqëzuara ndërmjet komponentëve të monitorimit që do të kryhen nga kolegët e AKK duke përkrahur Ekspertët e Panelit të Kualifikimit sipas nevojës. Është e qartë se përveç monitorimit “brenda institucionit” që do të jetë i vazhdueshëm përgjatë sistemeve të themeluara, po ashtu nevojiten Vizita për Monitorim të Jashtëm të cilat do të realizohen së paku në baza mujore në fazën fillestare. Nganjëherë këto mund të jenë vizita të jashtme “të dyfishta” nga Ekipi i Cilësisë dhe nga Eksperti/ekspertët e Panelit të Kualifikimit, në disa raste njëra palë ose tjetra varësisht nga rrethanat. Me themelimin e mëtejme të procesit të Monitorimit pas Akreditimit dhe pasi AKK të ketë një pasqyrë më të qartë të performancës së ofruesve, (p.sh. shkëlqyeshëm, mirë, ka nevojë për përmirësim, ka nevojë për veprim), do të ishte e arsyeshme që të ulet intensiteti i vizitave të jashtme tek “Ofruesit me performancë të shkëlqyer” dhe të fokusohen burimet dhe udhëzimet në përkrahje të ofruesve

me nivel më të ulët të performancës, dhe të inkurajohet “shkëmbimi i praktikave të mira” përmes rrjetave formale dhe joformale të ofruesve.

Sigurimi i cilësisë

Monitorimi dhe rishikimi i Raportit të Vetvlerësimit (RVV) të ofruesit

Dorëzimi i raporteve të vetvlerësimit të ofruesve tek ekipi i cilësisë në AKK ofron mundësi që AKK të ketë një pasqyrë të aktiviteteve të ofruesit si dhe ofron mundësi për të shqyrtuar RVV-në në raport me praktiken dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

Për të përforcuar monitorimin e RVV-ve të ofruesve, AKK do të zgjerojë procedurat ekzistuese për rishikim të RVV-ve përmes një “Liste kontrolli” (**Shih Shtojca A**), e cila të ndihmojë në ofrimin e komenteve kthyesë në raport. Koordinatorët e Cilësisë të ofruesve janë ndihmuar për zhvillimin dhe zbatimin e “Vet-vlerësimit” dhe për hartimin e RVV-së duke iu mundësuar qasje në një varg publikimesh të AKK-së, si dhe përmes punëtorive të vazhdueshme të ofruara dhe financuara nga ekipi i cilësisë i AKK-së. Kjo “Listë e kontrollit” e RVV-së do të ndihmojë Ekipin e Cilësisë në AKK të sigurojë një qasje konsistente për rishikimin e raporteve të ofruesve, qasje kjo e cila mund të dokumentohet dhe raportohet.

Monitorimi dhe rishikimi i planit të përmirësimit të ofruesve

Përveç “Listës së kontrollit” të RVV është zhvilluar edhe një formular raportimi për Planin e Ofruesit për Përmirësim (**shih Shtojca B**), i cili do të ofrojë dë11shmi se Plani i Përmirësimit i RVV reflekton komentet e raportit, identifikon përmirësimet që duhet të adresohen dhe iniciativat lokale, regjionale dhe nacionale të cilat AKK kërkon të zbatohen në Sistemin e Ofruesve.

NB

Është e rëndësishme që Ekipi i Cilësisë “Formalisht” të konfirmojë pranimin e RVV/PP nga ofruesit, dhe të dërgojë komentet kthyesë tek Koordinatorët e Cilësisë brenda një afati kohor realist dhe të arsyeshëm. Komentet kthyesë mund të ofrohen ose përmes një vizite tek ofruesi ose në formë elektronike. Plani për Përmirësim duhet të “dakortësohet” me ofruesin pasi që në disa raste PP mund të jetë jorealiste sa i përket rezultateve, afateve kohore ose përmbajtjes. Monitorimi i vazhdueshëm i PP-së së ofruesit mund të bëhet sërish në mënyrë elektronike duke u përkrahur me vizita të jashtme.

Monitorimi dhe rishikimi i kualifikimeve dhe moduleve të validuara

Për validimin e burimeve të ofruesit për të përkrahur ofrimin e fushave programore, AKK organizon përmes Panelit të ekspertëve të cilësisë të KAAP vizita në lokacionin e ofruesit për të inspektuar dhe siguruar se ekzistojnë burimet njerëzore dhe fizike, të cilat përbushin kërkesat e kualifikimeve/moduleve të programit të caktuar. Po ashtu për të siguruar ekzistimin e një kornize për vlerësim dhe verifikim të brendshëm, e cila kornizë do të ndihmonte vlerësimin e të nxëniet në programin e caktuar për të përkrahur arritshmërinë e nxënësit. Përveç kësaj vizite fillestare, AKK do të zgjerojë monitorimin e moduleve dhe kualifikimeve të validuara përmes vizitave të jashtme monitoruese në baza vjetore (fillimisht) nga Ekspertët e Panelit të Kualifikimit, dhe aty ku është e përshtatshme, ka mundësi të bëhet “Mostrim nga distanca” për ofruesit që përformojnë në nivel të “Shkëlqyer”. Detyrë e Ekspertëve të Panelit të Kualifikimit është të sigurojnë që vizitat e tyre të mos shihen si Inspektim i Jashtëm, por më shumë si vizita përkrahëse dhe këshillëdhënëse me qëllim të udhëzimit të ofruesve për veprime efektive që duhet të ndërmerren për të siguruar se të gjitha

vlërësimet e të nxënit, përfshirë edhe ato të kompetencave praktike, të kryera nga Ofruesit e Akredituar janë të drejta, të vazhdueshme, valide dhe plotësojnë kërkesat e kualifikimeve/ moduleve.

Gjatë vizitave të tyre, Ekspertët e Panelit të Kualifikimit pritet të vëzhgojnë dhe të dokumentojnë aktivitetet e ofruesit, dhe të sigurohen në emër të AKK-së se kualifikimi i miratuar ofron cilësinë e kërkuar nga proceset e validimit/akreditimit dhe:

- Mbajnë regjistrime të qarta të auditimit dhe raporton në AKK për aktivitetet e mësipërme.
- Këshillojnë dhe ndihmojnë ofruesit ku është e nevojshme sa i përket kualifikimeve dhe sigurimit të cilësisë në raport me ofrimin e programeve dhe monitorimin e tyre.
- Përkrahin ofruesit në trajnim dhe zhvillim.
- Ndhmojnë dhe këshillojnë ofruesit për zhvillimin e vlerësimit të brendshëm dhe sistemeve të tjera që janë të drejta, të besueshme dhe jo diskriminuese.
- Ofrojnë komente kthyesë me kohë, të sakta dhe konstruktive tek të gjitha palët relevante (AKK/ Paneli për Validim të kualifikimeve/moduleve) në raport me funksionimin e proceseve vlerësuese të ofruesve.
- Ndhmojnë dhe marrin pjesë në shkëmbimin e praktikave më të mira, në standardizim dhe në aktivitete trajnimi për të siguruar përkrahje për përmirësim të vazhdueshëm dhe performancë të qëndrueshme të ofruesve.
- Qëndrojnë në hap me zhvillimet/aktivitetet, shërbimet dhe sistemet IT të AKK-së për të mundësuar komunikim të besueshëm dhe qëndrueshëm me ofruesit.

NB

Në rast të Programeve Gjuhësore të cilat nuk validohen nga AKK por që duhet të monitorohen në raport me ofrimin e vlerësimit dhe verifikimit të brendshëm, kjo do të bëhet përmes procesit të RVV-së me përkrahje të Ekspertëve të Jashtëm të cilët ku është e nevojshme mund të realizojnë vizita bashkë me Ekipin për Sigurim të Cilësisë për të monitoruar këtë aspekt të aktivitetit të ofruesit.

Është e rëndësishme që Ekspertët e Panelit të Kualifikimeve (EPK), të cilët kryejnë këto vizita monitoruese të jenë në gjendje të lexojnë Aplikacionin e Ofruesit për Validimin të një Kualifikimi/ Moduli për të qenë në gjendje të familjarizohen me atë që ofruesit kanë deklaruar se ekziston në kuadër të organizatës së tyre për të siguruar cilësinë e ofrimit dhe zbatimit të Kualifikimeve/ Moduleve, dhe atë që është rënë dakord më pas përmes procesit të validimit, në mënyrë që ata të përfundojnë Raportin e Monitorimit Pas Akreditimit për Kualifikimet e Validuara, **(Shih Shtojcën C)**.

NB

Për të siguruar qëndrueshmëri në qasjen e vizitave të Monitorimit të Jashtëm nga Ekspertët e Panelit të Kualifikimeve duhet të ketë punëtori të përshtatshme trajnuese që do të lehtësojnë, mbështesin dhe sigurojnë se kolegët ekspertë janë trajnuar sipas një standardi të kërkuar dhe të pranuar të AKK (i cili do të kthehet në "Standard Kombëtar") në mënyrë që ata të kryejnë aktivitetet e monitorimit me një qasje profesionale dhe efektive.

Monitorimi dhe Rishikimi i Pajtuëshmërisë me Udhëzimet Administrative

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, (MASHT), ka nënshkruar Udhëzime Administrative të cilat duhet të respektohen nga Ofruesit. Udhëzimi Administrativ: Nr 32/2014 - Për kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit dhe aftësisimit profesional - proceset e brendshme. Në mënyrë të qartë përshkruan kërkesat e pajtuëshmërisë për ofruesit të cilat duhet të monitorohen nga AKK. Zhvillimi i sistemit për Monitorimin e ofruesve pas akreditimit lehtëson dhe ndihmon AKK-në për të siguruar se këto Udhëzime Administrative janë duke u zbatuar dhe vazhdojnë të jenë pjesë përbërëse e aktiviteteve.

Ky dokument është zhvilluar në kuadër të projektit ALLED "Harmonizimi i Arsimit me Kërkesa të Tregut të Punës"

Shtojca A

Sigurimi i Cilësisë Raporti i Monitorimit Pas Akreditimit (SCRMPA)

Emri i ofruesit: Lista e kontrollit dhe dokumenti raportues për monitorimin dhe vlerësimin e një Ofruesi të Akredituar në raport me Vetëvlerësimin dhe Planin e tyre të Përmirësimit			
	Po	Jo	Komentet kthyesë dhe aktivitetet pasuese. Referojuni seksioneve / rreshtave specifik të Raportit të Vetëvlerësimit nëse nevojiten aktivitete pasuese.
Pyetje në lidhje me kriteret e AKK Shënimet poshtë secilës pyetje janë udhëzim për procesin e rishikimit dhe monitorimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<u>PROCESI I VETËVLERËSIMIT</u>			
1. A ka inkurajuar procesi i vetëvlerësimit stafin në të gjitha nivelet për të vlerësuar performancën e tyre? <ul style="list-style-type: none"> • Shikoni hyrjen e raportit • A ka dëshmi se si është përgatitur raporti dhe kush ka qenë i përfshirë? • A janë zhvilluar nën-raportet si pjesë e procesit dhe a janë "në pronësi" të ekipeve? • A keni nevojë për ndonjë informacion / dëshmi të shtesë? 	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
2. A ka përfshirë procesi i vetëvlerësimit nxënësit, punëdhënësit dhe klientët e tjerë? (SPOC / EPOC) <ul style="list-style-type: none"> • Shikoni hyrjen e raportit dhe faktet e ofruara në tekst të raportit. • A ka referencë për pikëpamjet e nxënësve / punëdhënësve / palëve të interesuara / klientëve të mbledhura me anë të sondazheve apo me metoda të tjera, p.sh. Fokus grupe apo përfaqësim në takime? • A keni nevojë për dëshmi / informacion të mëtejshëm? 	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
3. A është procesi pjesë integrale e aranzhimeve për sigurim të cilësisë? <ul style="list-style-type: none"> • Shikoni hyrjen e raportit. A ka ndonjë referencë për lidhjet ndërmjet vetëvlerësimit dhe planifikimeve tjera/procedurave për SC? • A keni nevojë për dëshmi / informacion të mëtejshëm? 	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<u>STRUKTURA, TË KUPTUARIT DHE MBULIMI.</u>			
1. A është struktura e raportit e qartë dhe e përshtatshme? <ul style="list-style-type: none"> • Shikoni raportin e vetëvlerësimit si tërësi. • A janë të paraqitura të gjitha seksionet e kërkuara dhe a ndjekin strukturën e miratuar? 			

<ul style="list-style-type: none"> • A përfshihen të gjitha informacionet e nevojshme të sfondit - përgjithësisht dhe për çdo seksion? • A janë të ndara në mënyrë të qartë përshkrimi dhe vlerësimi? • A nevojiten nën-raportet për të sqaruar raportin? • A është e lehtë të bëjmë referim të kryqëzuar apo të lidhim gjykimet, provat dhe veprimet? • A ka nevojë ofruesi për mbështetje të mëtejshme për të ndihmuar në strukturimin më të mirë të RVV? • Si mund të përkrahet kjo më së miri? 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
<p>2. A merret raporti me të gjitha aspektet e aktivitetit të Ofruesit, veçanërisht me cilësinë e përvojës së nxënësve/ kandidatëve dhe standardeve që ata arrijnë?</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shikoni raportin e vetëvlerësimit në tërësi. • A janë adresuar të gjitha fushat profesionale të mësimit? • A janë adresuar të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me udhëheqjen dhe menaxhimin? • A fokusohet raporti në mënyrë të mjaftueshme në cilësinë e përvojës së nxënësve dhe standardeve që ata arrijnë? • Çfarë informacioni shtesë ju nevojitet për ndonjë prej aspekteve? • Si mund ta merrni më së miri këtë informacion? 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
<p>3. A i pasqyron raporti prioritetet / kriteret e cilësisë të përcaktuara në kornizën e AKK-së?</p> <p>Sa rezultate të mira arrijnë nxënësit/ kandidatët?</p> <ul style="list-style-type: none"> • A mban ofruesi të dhënave të sakta të performancës. A ka prova që trendet e performancës janë analizuar për të informuar rezultatet e raportit? A janë përmirësuar normat e vazhdimin dhe arritjes? • A është e dukshme se si janë analizuar arritjet e nxënësit për progres? (Në punësim / trajnim / arsimim të mëtejshëm). • A ka ndonjë informacion në lidhje me "shkathtësitë bazike " <p>Sa efektive janë mësime dhënia, trajnimi dhe të nxënit?</p> <ul style="list-style-type: none"> • A ka dëshmi se ka pasur një vlerësim të ekspertizës së stafit/ vëzhgim të orëve mësimore dhe trajnuese? • A tregon raporti se si është planifikuar, mbajtur mësimi dhe si është monitoruar progresi për secilën fushë profesionale? • A i referohet vlerësimit fillestar, planeve të vlerësimit etj? • A ka ndonjë dëshmi se punëdhënësit dhe nxënësit janë plotësisht të përfshirë në procesin e trajnimit? • Dëshmi të nivelit të lartë të kënaqësisë mes nxënësve dhe punëdhënësve? <p>Si ndikohen arritjet dhe të mësuarit nga burimet?</p> <ul style="list-style-type: none"> • A i referohet raporti ekspertizës së stafit - a ka një tabelë që tregon kualifikimet / përvojën / ekspertizën e stafit? A ka staf të mjaftueshëm dhe me përvojë? • A ekziston një plan i azhurnuar për zhvillimin profesional dhe trajnimin e të gjithë stafit? A i është referuar ofruesi 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	

<p><i>planeve për zhvillim të stafit?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • A ka raporti ndonjë referencë për përfshirjen dhe ekspertizën e industrisë? • A ekziston një vlerësim i përshtatshmërisë së akomodimit, burimeve mësimore dhe pajisjeve? • A i referohet raporti mbështetjes / burimeve të specializuara për nxënësit me nevoja të veçanta mësimore? <p><u>Shëndeti & Siguria</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • A i referohet raporti Shëndetit dhe Sigurisë - Monitorimi i vendit të punës, ndërgjegjësimi i nxënësve, raportimi/ regjistrimi i aksidenteve? • A përmend raporti ndonjë promovim të praktikave "për punë të sigurte" në kuadër të programeve mësimore? 	<p><input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/></p>	
<p>4. Sa efektive janë vlerësimi dhe monitorimi i të nxënit?</p> <ul style="list-style-type: none"> • A tregon raporti se ofruesi ka bërë gjykime mbi cilësinë dhe përshtatshmërinë e metodave të vlerësimit, të dhënat mbi progresin, vlerësimet, saktësinë e monitorimit fillestar të vlerësimit të progresit, përfshirjen e punëdhënësve? • A ka dëshmi se ekziston planifikim efektiv të mësimin dhe monitorimit të progresit? • A ka prova që tregojnë se ofruesi ka analizuar performancën e nxënësve dhe ka përdorur rezultatet për të udhëhequr zhvillimin e programit? <p>Sa mirë i plotësojnë programet dhe kurset nevojat dhe interesat e nxënësve/ kandidatëve?</p> <ul style="list-style-type: none"> • A ka dëshmi se programet janë gjithëpërfshirëse në aspektin shoqëror? • A tregon raporti nëse programet i plotësojnë aspiratat e nxënësve? • A marrin parasysh programet nevojat e punëdhënësve dhe të komunitetit? • A ka dëshmi që ofruesi ka vlerësuar efektivitetin e "trajnimin në punë dhe jashtë punës"? (Në-shkollë/ Biznes) <p>Sa mirë udhëzohen dhe përkrahen nxënësit?</p> <ul style="list-style-type: none"> • A i është referuar ofruesi menaxhimit të aranzhimeve për mbështetje? • A ka dëshmi për udhëzime efektive dhe edukim karriere? • A i është referuar ofruesi efektshmërisë së "Programit hyrës/ fillestar"? • A i është referuar ofruesi efektshmërisë së mbështetjes personale/ qasjes në shërbimet e mbështetjes specialiste? <p>Udhëheqja dhe Menaxhimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • A ka dëshmi që tregon se ofruesi ka bërë gjykime të sakta se sa mirë menaxherët kanë vendosur një drejtim të qartë të programeve të tyre të arsimit dhe trajnimit (të ndërlidhura me direktivat strategjike, planet e biznesit etj.)? 	<p><input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/></p> <p><input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/></p> <p><input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/></p>	

<ul style="list-style-type: none"> • A i referohet raporti objektivave për përmirësime? • A i referohet raporti përdorimit dhe monitorimit të informacionit të menaxhimit për të përmirësuar cilësinë dhe për të informuar vendimet? A përmban raporti të dhëna për vazhdimet dhe arritjet gjatë 3 viteve të fundit? • A është bërë referencë për efektivitetin e menaxhimit të performancës, vlerësimin dhe shqyrtimit të stafit? • A i është referuar ofruesi efektivitetit financiar dhe ndershmërinë? • A ka referencë për planet e ofruesit për përfshirjen dhe zbatimin e prioriteteve lokale, rajonale dhe kombëtare? • A i referohet raporti një rishikimi sistematik dhe të rregullt të menaxhimit të "Procesit të Përmirësimit të Vazhdueshëm"? • A i është referuar ofruesi efektivitetit të marrëdhënieve të tij të punës me organet e jashtme (AKK / MASHT / KAAP) dhe "aktorët kryesorë" të tjerë? 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
<p>Sigurimi i Cilësisë</p> <ul style="list-style-type: none"> • A tregon raporti se ofruesi posedon një kornizë sistematike të sigurimit të cilësisë, e cila përfshin plotësisht stafin dhe mbulon të gjitha fushat e procesit të trajnimit/ mësimi? A mund të tregoni se si ofruesi përdor vlerësimin, komentet kthyesë dhe informacionet (p.sh. Të dhënat, vëzhgimi i trajnimit dhe mësimdhënies) për të bërë përmirësime në ofrimin e tyre? • A i referohet raporti efikasitetit të kornizës së sigurimit të cilësisë së ofruesit, duke përfshirë procesin e vetëvlerësimit, dhe monitorimin dhe përditësimin e rregullt të Planit Zhvillimor? • A ka treguar ofruesi se ekzistojnë mekanizma efektive për stafin, nxënësit, punëdhënësit dhe palët e tjera të interesit, dhe a ka prova që informatat kthyesë kanë njoftuar RVV-në? • A ekziston një listë e pikave të forta/ dobëta që ndërlidhen posaçërisht me SC? • A ka ndonjë dëshmi të krahasimit (lokal / kombëtar), dhe të shkëmbimit të praktikave të mira? • A ka dëshmi që tregojnë ndonjë përmirësim nga informacionet e marra. 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
<p>Mundësitë e barabarta</p> <ul style="list-style-type: none"> • A përmban raporti ndonjë referencë për mundësitë e barabarta? • A i referohet raporti planeve të ofruesit për promovimin e mundësive të barabarta? • A ka dëshmi për veprime specifike të ndërmarra për të rekrutuar dhe mbajtur nxënësit nga grupet më pak të përfaqësuara? • A ka referencë për ndonjë trajnim të stafit që lidhet me këtë çështje? • A ka ndonjë anë të fortë/ dobësi që lidhet posaçërisht me EO? • A ka ndonjë referencë për kuptueshmërinë e punëdhënësve për EO? 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
<p>A janë "Parimet kryesore" të lidhura me sigurimin e cilësisë të mbuluara mjaftueshëm në seksionet përkatëse të RVV-së?</p> <ul style="list-style-type: none"> • A janë adresuar në mënyrë adekuate arritjet e nxënësit? • Çfarë informacione shtesë ju nevojiten? • Si mund ta gjeni më së miri këtë informacion? 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	

<p>5. Gjykimet dhe dëshmitë</p> <p>(Nëse raporti përmban seksione të veçanta për secilën fushë të mësimit, mund ta keni më të lehtë të kopjoni këtë pjesë të listës së kontrollit dhe ta përdorni nga një kopje për secilën fushë mësimore)</p> <p>A është raporti i sinqertë, vlerësues dhe vetëkritik?</p> <ul style="list-style-type: none"> • A janë gjykimet vlerësuese? • A janë identifikuar dobësitë dhe pikat e forta kryesore? • A janë elaboruar pikat e forta dhe të dobëta në mënyrë të qartë dhe të përshtatshme? • A janë balancuar apo kontradiktuar anët e forta me ato të dobëta? • A ka lëshime apo mangësi në raport? <p>A përdor raporti prova të forta dhe të verifikueshme për të mbështetur gjykimet?</p> <p>Shikoni raportin seksion pas seksioni. A janë dëshmitë e çdo seksioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Valide (të lidhura qartë me gjykimin dhe përkrahin atë) • Të kuantifikuara/ specifike • Të mjaftueshme (jo selektive dhe të pa përfunduara) • Aktuale (mjaft aktuale për të ofruar një pamje të saktë) • Të sakta? • A përdoren burimet kryesore të dëshmive (të dhënat e vazhdimit/ arritjes, të dhënat e vëzhgimit kur është e përshtatshme)? • A është bërë verifikimi apo validimi i brendshëm i gjykimeve? • A janë bindëse procedurat për ta bërë këtë? • Cilat gjykime dhe dëshmi do të përdorni për të verifikuar vlerësimin? • Cilat të dhëna tashmë i keni në dispozicion për t'i kontrolluar gjykimet? <p>A përdor raporti në mënyrë efektive të dhënat kryesore të performancës dhe informatat e menaxhimit për krahasimet e brendshme/ të jashtme të performancës?</p> <ul style="list-style-type: none"> • Standardet kombëtare për vazhdim dhe arritjet. • Standardet kombëtare për anketim të nxënësve/ stafit 	<p><input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/></p> <p><input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/></p> <p><input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/></p>	
<p>Përmbledhje e komenteve kthyesë për ofruesin:</p>		
<p>Veprimet përcjellëse që duhet të ndërmerren më tej për vlerësimin e raportit: Menjëherë:</p>		

Në vizitën monitoruese të radhës:		
Shënime shtesë		
Nënshkrimi:	Ekipi i cilësisë AKK	Data:

Shtojca B

Raporti i Monitorimit Pas Akreditimit – Plani i Përmirësimit (RMPP)		
Listë kontrolli për raportim dhe dokument për vlerësimin e cilësisë dhe efektivitetit të Planit të Përmirësimit të një Ofruesi të Akredituar.	Po Jo <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	Komentet. Referojuni seksioneve/ rreshtave specifik të Raportit të Vetë-Vlerësimit nëse nevojiten aktivitete përcjellëse.
Përgjigje në raportin e vetëvlerësimit – Mbulueshmëria. <ul style="list-style-type: none"> A adreson plani i përmirësimit të gjitha dobësitë kryesore të identifikuar në raportin e vetëvlerësimit? A janë ato lehtë të kontrollueshme? A përcakton plani i përmirësimit fushat për përmirësim që janë me rëndësi për nxënësin? A përfshin plani veprime për të mirëmbajtur pikat e forta dhe për të ndërtuar mbi to? A identifikon plani zonat për përmirësim që duhet të adresohen në planin afatgjatë, por që nuk janë kritike në këtë fazë? A reflektohen ato në afatet kohore? 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
Përgjigjet ndaj prioriteteve lokale, rajonale dhe kombëtare <ul style="list-style-type: none"> A i adreson plani prioritetet kombëtare/ rajonale në të cilat kërkohet veprim? A i adreson plani prioritetet lokale në të cilat kërkohet veprim? A kanë kontribuar "palët e interesuara/ partnerët kryesorë" në plan kur ka qenë e përshtatshme? A reflekton plani prioritetet aktuale operative dhe strategjike të ofruesit? 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	

<p>Cilësia dhe efektshmëria e planit</p> <ul style="list-style-type: none"> • A janë përcaktuar qartë natyra dhe shtrirja e çështjeve? • A adreson secili veprim në mënyrë të qartë problemet dhe a kontribuon në rezultatin apo cakun e dëshiruar? • A janë rezultatet ose caqet: <p>S Specifike M të Matshme A të Arritshme R Reale/të orientuara kah rezultatet T të përcaktuara në aspektin kohor</p> <ul style="list-style-type: none"> • A janë ato mjaft specifike për të përkrahur monitorimin e planit? • A kontribuon çdo veprim direkt në rezultatin/ cakun e dëshiruar? • A ka secili veprim nga një person përgjegjës të emëruar? • A janë afatet kohore realiste? • A do të sigurojnë aranzhimet e monitorimit dhe rishikimit që plani të mbetet në rrugën e duhur? <p>Vlerësimi i përgjithshëm i planit zhvillimor</p> <ul style="list-style-type: none"> • A janë veprimet, të marra së bashku, të mjaftueshme për të sjellë përmirësime të rëndësishme? • A është plani realist dhe i arritshëm? • A është përmirësimi i qëndrueshëm? 	<p><input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/></p> <p><input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/></p>	
<p>Veprimet përcjellëse që duhet të ndërmerren:</p>		
<p>Nënshkrimi: _____ Data: _____</p>		

Shtojca C

Raporti i Monitorimit Pas Akreditimit – Kualifikimet e Validuara (RMKV)

Detaje të vizitës

Emri i ofruesit			
Numri i vendimit të akreditimit dhe validimit			
Adresa e ofruesit			
Emri i ofruesit			
Koordinatori për sigurim të cilësisë			
Emri i ekspertit të panelit të kualifikimit (EPK)			
Data e vizitës			
Natyra dhe kohëzgjatja e aktivitetit	Takimet gjatë vizitës	Vëzhgim i vlerësimit	Kohëzgjatja e aktivitetit (orë)

2. Kualifikimet e validuara që ofrohen nga ofruesi

Ju lutem listoni të gjitha kualifikimet që janë shqyrtuar gjatë vizitës, dhe shënjoni statusin përkatës të kualifikimit për të treguar rekomandimin tuaj për miratim.

Titulli i kualifikimit të validuar	Numri dhe data e skadimit të kualifikimit	Numri i nxënësve/kandidatëve	Statusi i kualifikimit		
			Miratim i plotë <input type="checkbox"/>	Validim i kushtëzuar <input type="checkbox"/>	Heqje e validimit

3. Përmbledhje e raportit			
Pas shqyrtimit të fakteve që keni mbledhur përmes vëzhgimeve dhe intervistave të kryera, a mendini se ofruesi plotëson kërkesat e AKK? (Ju lutëm shënjoni Po ose Jo). Ju lutem përdorni këtë pjesë për të adresuar ndonjë rast të neglizhencës, mosrespektimit apo ndonjë rrezik tjetër të vërejtur gjatë aktivitetit.		PO <input type="checkbox"/>	JO <input type="checkbox"/>
Komente:			
Veprimet e rekomanduara			
Eksperti i Panelit të Kualifikimit (EPK)		Data	

4. Plani paraprak i veprimit (nëse është e aplikueshme)				
Ju lutem ofroni detaje të veprimeve të ndërmarra				
Nr.	Veprimi	Nga kush	Është zbatuar plotësisht	
			Po	Jo
1	Zhvilloni një rregullore formale për ankesa për ta ndarë me nxënësit	Personi përgjegjës për sigurim të cilësisë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2	Stafi vlerësues – regjistri i Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional të mirëmbahet dhe të jetë në dispozicion për QPE	IV	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

5. Plani i veprimit			
Ju lutem ofroni detaje të veprimeve që kërkohen.			
Nr.	Veprimi	Kush	Afati i përfundimit
1			
2			
3			

6. Personeli që është takuar gjatë vizitës		
Nr.	Emri	Pozita tek ofruesi
1		
2		
3		

Për secilin aktivitet të QEP kërkohet një mostër përfaqësuese e vlerësimeve. Vizitat duhet të planifikohen në mënyrë që të vëzhgohet vlerësimi drejtpërsëdrejti, por në raste ku vëzhgimi nuk është i mundur, mund të mbledhen dëshmi tjera. Ju lutem regjistroni gjetjet e juaja më poshtë, duke përshkruar në detaje llojin e vlerësimit.

7. Pasqyra e vlerësimit								
Referenca e mostrës	1		2		3		4	
Lloji i vlerësimit								
Data e vlerësimit								
Emri dhe mbiemri i nxënësit/ kandidatit								
Numri i regjistrimit i nxënësit/ kandidatit								
Data e regjistrimit								
Kualifikimi dhe numri i modulit								
Emri i vlerësuesit								
Ku është bërë vlerësimi	Ofruesi / Tjetër		Ofruesi / Tjetër		Ofruesi / Tjetër		Ofruesi / Tjetër	
A pajtoheni me vendimin e vlerësuesit?	Yes <input type="checkbox"/>	No <input type="checkbox"/>	Yes <input type="checkbox"/>	No <input type="checkbox"/>	Yes <input type="checkbox"/>	No <input type="checkbox"/>	Yes <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
A i është bërë verifikim i brendshëm këtij vlerësimi?	Yes <input type="checkbox"/>	No <input type="checkbox"/>	Yes <input type="checkbox"/>	No <input type="checkbox"/>	Yes <input type="checkbox"/>	No <input type="checkbox"/>	Yes <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Data e verifikimit të brendshëm								
Emri i verifikuesit të brendshëm								
Nëse këtij vlerësimi i është bërë verifikim i brendshëm, a pajtoheni me VB?	Yes <input type="checkbox"/>	No <input type="checkbox"/>	Yes <input type="checkbox"/>	No <input type="checkbox"/>	Yes <input type="checkbox"/>	No <input type="checkbox"/>	Yes <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Komente (të veçanta për nxënësin/ vlerësimin, njësinë/ VB)								

8. Vëzhgimi i vlerësimit – të plotësohet vetëm nëse vlerësimi është vëzhguar drejtpërsëdrejti nga QPE. Komentet rreth vlerësimit të pavëzhguar duhet të jepen në Seksionin 7.

Përmes vëzhgimit, pyetjeve dhe shqyrtimit të vlerësimit e shënimeve të IV, vendosni nëse ofruesi plotëson në tërësi kriteret në vijim. Ju lutem shënjoni kutinë përkatëse për secilin kriter. Nëse shënjoni kutinë 'Jo', atëherë ju lutem ofroni komente që mbështesin vendimin tuaj.

Kriteret	I zbatuar plotësisht?		Komente
	Po	Jo	
Para vlerësimit, secili vlerësues siguron se: <ul style="list-style-type: none"> Të gjitha burimet e nevojshme ishin në dispozicion dhe të gatshme për përdorim Planet e vlerësimit sipas kërkesave të kualifikimit ishin të zhvilluara për secilin nxënës/kandidat 	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Gjatë vlerësimit secili vlerësues: <ul style="list-style-type: none"> Bëri vlerësimin në mënyrë të pavarur Vlerësoi njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për kualifikimin Shtroi pyetje me ton inkurajimi pa synuar të udhëheqë nxënësin/ kandidatin 	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Pas vlerësimit, secili vlerësues: <ul style="list-style-type: none"> Qartësoi dhe zgjidhi mospërputhjet eventuale në dëshmi Informoi nxënësit/ kandidatët për vendimin e vlerësimit dhe ofroi komente kthyese të qarta dhe konstruktive Përbushi nevojat e nxënësit dhe ishte në përputhje me nivelin e vet-besimit të tij/ saj. Këshilloi nxënësit se si të kërkojnë qartësime /këshilla rreth vendimit të vlerësimit Plotësoi nga një regjistër të vlerësimit për secilin nxënës 	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Secili vlerësues mund të shpjegonte në nivel të kënaqshëm veprimet që do të ndërmernte në rast se do të shfaqeshin vështirësi në lidhje me gjykimin e dëshmimeve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Secili vlerësues mund të shpjegonte në nivel të kënaqshëm procedurën për bartjen e shënimeve tek IV për fazën tjetër të procesit të regjistrimit/certifikimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	

Secili vlerësues siguri se dëshmitë e nxënësve janë regjistruar në atë mënyrë që tregon se të gjitha kërkesat e kualifikimit janë mbuluar dhe se njohuritë e nevojshme janë vlerësuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Secili vlerësues siguroi se dëshmitë e nxënësit ishin: <ul style="list-style-type: none"> • Valide • Autentike • Aktuale • Të mjaftueshme për të demonstruar se nxënësi është në gjendje të përformojë në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me standardet e profesionit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
9. Menaxhimi dhe administrimi i kualifikimeve të validuara			
Kriteret	I zbatuar plotësisht?		Komente
	Po	Jo	
Ekziston një sistem efektiv i komunikimit ndërmjet niveleve të ndryshme të stafit dhe në të gjitha drejtimet.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Vlerësimi kryhet në një vend të përshtatshëm	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Ekzistojnë të dhëna të kompletuara dhe të përditësuara që tregojnë gjykimin e dëshmimeve, vendimet e vlerësimit dhe regjistrimet e nxënësve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Informatat ruhet në mënyrë të sigurte dhe u tregohen vetëm atyre që kanë të drejtë t'i shohin.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Të dhënat që kërkuat ishin në dispozicion.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Ekzistojnë procedura të ankesave të cilat janë të kuptueshme për nxënësit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	

10. Kualifikimet e validuara, burimet fizike dhe stafi, përditësimet e kërkesave – Paneli i ekspertëve të programit duhet t'i referohen formularëve relevant për validimin e Kualifikimeve/Moduleve

Kriteret	I zbatuar plotësisht?		Komente
	Po	Jo	
Pajisjet, softueri (nëse është në dispozicion), procedurat dhe akomodimi janë të mjaftueshme, të përshtatshme, duken të sigurta dhe të përdorshme, përfshirë kërkesat eventuale.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Materialet e nevojshme për vlerësuesit e rinj janë në dispozicion dhe të përshtatshëm.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Kualifikimet janë të pajisura me staf adekuat.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
I tërë safi aktual është i miratuar dhe ka kryer kualifikimet e njohura përkatëse, dhe kanë ZHVP për kualifikime	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Lista e stafit është e përditësuar.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	

11. Sigurimi i cilësisë së kualifikimeve të validuara

Kriteret	I zbatuar plotësisht?		Komente
	Po	Jo	
Vlerësuesit mbahen të përditësuar dhe kanë qasje në të gjitha dokumentet relevante dhe materialin mbështetës të AKK-së.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Ekziston një sistem efektiv për verifikuesin e brendshëm për të mostruar gjykimin e dëshmimeve dhe vendimet e vlerësimit në raport me kërkesat e kualifikimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Vlerësuesit kanë përkrahje relevante nga verifikuesit e brendshëm për të arritur konsistencë në vlerësim dhe këshilla të sakta për përdorimin e llojeve të ndryshme të dëshmimeve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Ekzistojnë mundësi adekuate për vlerësuesit dhe anëtarë tjerë relevant të ekipit për t'u takuar dhe për të diskutuar çështje që kanë të bëjnë me vlerësimin dhe me sigurimin e cilësisë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	

12. Kriteret për mostrim nga distanca (të plotësohet vetëm në rast se nuk është kryer vizita tek ofruesi) – të plotësohet vetëm për aktivitetin e mostrimit nga distanca

Kriteret	I zbatuar plotësisht?		Komente
	Po	Jo	
A është bërë vlerësimi dhe regjistrimi i vlerësimit në pajtim me kërkesat e kualifikimit dhe nga vlerësues të kualifikuar?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Nuk u realizua vizitë
E ekziston një strategji efektive për mostrim IV?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Nuk u realizua vizitë
A janë dërguar të gjitha regjistrimet/dëshmitë me kohë, para mostrimit nga distanca? Ju lutem regjistroni dëshmitë/dokumentet e dërguar.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Nuk u realizua vizitë
A kanë qenë në dispozicion të gjitha regjistrimet e vlerësimit/IV, të nënshkruara në mënyrën e duhur, dhe a përputhen datat e regjistrimit tuaj me regjistrimet e ofruesit?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Nuk u realizua vizitë
A ishte stafi vlerësues në dispozicion për t'i kontaktuar sipas nevojës gjatë mostrimit nga distanca?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Nuk u realizua vizitë

Draft Guidelines